

NJOFTIM
Nr. 4196, datë 13.10.2023

**PËR SHPALLJEN E 1 (NJË) VENDI VAKANT PËR POZICIONIN E KËSHILLTARIT
LIGJOR NË KOMISIONIN E PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Këshilltarit Ligjor, me kategorinë e pagës: 80% e G3.

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

- a) Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “Master shkencor”, në Shqipëri, ose studimet universitare për drejtësi jashtë vendit dhe të ketë marrë diplomë të njësuar, sipas legjislacionit në fuqi për njësimin e diplomave;
- b) Të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze;
- c) Të ketë shtatë vjet përvojë pune në sistemin e drejtësisë ose në administratën publike.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit nr. 188, datë 4.3.2015, të Këshillit të Ministrave;
- Ndaj tij të mos jetë nisur procedim penal dhe të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur dhe për të punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidati i interesuar duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

- Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;
- Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- Kopje të dokumenteve: diplomë, letërnjoftim dhe librezë pune (originale ose të noterizuara);
- Dëshmi penaliteti;
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen **brenda datës 29 tetor 2023**, pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në adresën: Rruga e Kavajës, ish-godina e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e hëna–të premte, ora 08:30–17:00, ose nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@kpk.al, që konfirmon marrjen e aplikimit përkatës.